

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESEM 2002-2004

A. Hyrje

1. Vitin e kaluar Qeveria prezantoi Programin Afatmesem Buxhetor (PBA). Ky dokument i pare i PBA, i cili mbuloi periudhen 2001-03, arriti nje sukses te konsiderueshem duke krijuar nje baze me te forte per pergatitjen e Buxhetit te vitit 2001 (Kutia 1). Ndertuar mbi kete baze, analiza per PBA 2002-04 u zgjerua ne menyre te konsiderueshme si ne drejtim te shtrirjes ashtu edhe te thellesise se saj. Ajo perfshiu nje analize me te detajuar te problemeve te personelit e pagave si dhe te implikimeve te decentralizimit fiskal. Analiza e programeve te shpenzimeve sektoriale qe u shtri edhe ne sektorin e bujqesise, kishte te bente me nje analize me te detajuar te prioriteteve dhe te alokimeve ne nivel programi. Projektionet e burimeve qe u zhvilluan ne nivel sektori dhe ministrie, do te perbejne tavanet kundrejt te cileve do te vleresohen kerkesat per buxhetin e vitit 2002. Pergatitja e PBA 2002-04 u be brenda kuadrit te Strategjise se Rritjes Ekonomike dhe Uljes se Varferise (GPRS). Prioritetet e GPRS perbene drejtimin strategjik per alokimin e burimeve buxhetore ne PBA. Ne ministrite e linjes te njejtet grupet pune ishin te ngarkuar me pergjegjesine e pergatitjes se te dy dokumenteve: GPRS dhe PBA.

Kutia 1: Programi Buxhetor Afatmesem - Qellimet

PBA ofron nje analize te gjithanshme te shpenzimeve publike. Keshtu ai mbulon si shpenzimet korrente ashtu edhe ato per investime; ai perfshin si shpenzimet buxhetore ashtu edhe shpenzimet e financuara nga kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore. PBA synon qe te:

- * Nxise disiplinën fiskale duke siguruar planifikimin e shpenzimeve publike brenda nje kuadri realist makroekonomik dhe fiskal;
- * Mundesoje percaktimin e prioriteteve te shpenzimeve publike duke lidhur ne menyre eksplicite politikat e qeverise me planet e shpenzimeve;
- * Inkurajoje nje efikasitet me te madhe teknik ne shperndarjen dhe perdorimin e burimeve buxhetore; dhe
- * Sjelle me shume parashikueshmeri ne procesin e buxhetit, duke lejuar qe ministrite te planifikojne programet e tyre te shpenzimeve ne afat te mesem.

2. Dokumenti i PBA perbehet nga raporti kryesor dhe nje sere aneksesh. Raporti kryesor perfshin pese pjese:

Pjesa B: permbledh situaten makroekonomike per periudhen 2002-04 dhe ndikimin e pritshem te saj mbi burimet ne dispozicion te buxhetit dhe mbi kerkesat per shpenzime publike;

Pjesa C: analizon kuadrin e burimeve per vitet 2002-04 duke trajtuar projektionet mbi te ardhurat e qeverise dhe mbi financimin e huaj dhe te brendshem;

Pjesa D: shqyrton problemet e shpenzimeve dhe percakton projektionet per secilen nga kategorite kryesore te shpenzimeve publike;

Pjesa E: trajton problemet e decentralizimit fiskal dhe implikimet e tij;

Pjesa F: jep nje analize te prioriteteve te shpenzimeve sektoriale dhe te alokimeve te burimeve per PBA 2002-04 duke u fokusuar ne kater sektore kryesore: bujqesi, shendetesi, arsim, pune e mbrojtje sociale, dhe transport.

3. Aneksat perfshijne: (i) permbledhjen e tabelave fiskale; (ii) analizen me te detajuar te problemeve specifike (reformen ne sistemin e pagave, decentralizimin fiskal dhe financimin e huaj te investimeve publike); (iii) permbledhjen e strategjive sektoriale te shpenzimeve te pergatitur nga ministrite e linjes.